



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:082976

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06000904

KPPP.nr.479/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “28 Nëntori” nr.4, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.189/24, të datës 28.02.2024, të Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.189/24, të datës 28.02.2024, të Përbaruesit Privat Flamur S. Bogaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr.189/24, i datës 28.02.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.189/24, të datës 28.02.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor - Aktvendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 01/56-132/23-B të datës 08.06.2023, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumën prej 3,500.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përbaruesit privat, si dhe regjistrimin,

sekuestrimit, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Tutje ka shtuar se në vendimin i cili është objekt i kësaj procedure përmbarimore mungon adresa e kreditorit si dhe koha e përmbushjes së detyrimit andaj urdhri i lejuar nuk i plotëson kushtet sipas nenit 24 dhe 38 të LPP-së. debitori kundër vendimin të kreditorit ka ushtruar padi pranë gjykatës kompetente, andaj procedura përmbarimore në këtë çështje duhet të pezullohet deri në një vendim sipas padisë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj urdhrin përmbarimor, ta pezulloj procedurën përmbarimore si dhe ta detyroj kreditorin që t'ia kompensoj debitorit shpenzimet e procedurës.

Kreditori me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, kreditori urdhrin përmbarimor e ka mbështetur në aktvendimin i cili është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, andaj urdhri përmbarimor është i bazuar i argumentuar dhe i ekzekutueshëm. Tutje ka shtuar se vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndal ekzekutimin e vendimit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktvendimin Nr. 01/56-132/23-B të datës 08.06.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe

gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr. 01/56-132/23-B i datës 08.06.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr. 01/56-132/23-B i datës 08.06.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimit Nr. 01/56-132/23-B i datës 08.06.2023, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 14.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 14.09.2023.

Gjykata vlerësoi pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.479/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.